



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 9^{-të} e Legjislacionit të VI^{-të} të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 27.09.2018, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|--------------------------|----------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 12. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 13. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 3. Naim Behlulaj, LDK; | 14. Arben Kabashi, PDK; |
| 4. Haki Podrimaj, LDK; | 15. Ajshe Metaj, PDK; |
| 5. Selajdin Bytyqi, LDK; | 16. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 6. Valbona Demaj, LDK; | 17. Lavdiye Bujupaj, VV; |
| 7. Edona Lubeniqi, LDK; | 18. Arif Elshani, AE; |
| 8. Naim Imeraj, AAK; | 19. Radoš Repanović, SL; |
| 9. Nexhmedin Balaj, AAK; | 20. Radenko Belošević, RB; |
| 10. Muhamet Ukaj, AAK; | 21. Slaviša Maliković, SM. |
| 11. Eliot Kukiqi, AAK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Kryetari i Komunës z. Haki Rugova, Nënkryetari i Komunës z. Lulzim Blakaj, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Procesverbali

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit për shpalljen qytetar nderit z. **Peter Beyer MdB;**
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2019-2021;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për dhenjen në shfrytëzim të pronës Komunale përmes ankand publik për zhvillim ekonomik;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt- Rregullores për të drejtat, detyrat, përgjegjësinë disiplinore të punonjësve në institucionet Edukativo-Arsimore;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për transferin dhe rialokimin e mjeteve për vitin 2018;
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Arben Kabashi, PDK – përshëndet të gjithë të pranishmit, propozon që pika e tetë e rendit të ditës të hiqet ose të hy si pik e parë në këtë rend të ditës.

Kryesuesi – nuk ka diçka të keqe që është kjo pikë këtu .

Hedhe në votim propozimin e Arben Kabashit anëtar i PDK-së

Miratohet me vota të njëjta 9 për dhe 9 kundër kryesuesi me të drejtën e votës së dyfishtë

Vendoset që kjo pikë të mbetet ashtu siç edhe është në

Arif Elshani, IQ – përshëndet të gjithë të pranishmit pyete pse nuk janë mediat prezent në sallë gjatë mbledhjes pse nuk është TV dukagjini në legjislacionin e kaluar e kemi pasur, pasi që nuk kemi TV të Istogut ende.

Hedhe në miratim këtë pikë të rendit të ditës:

U vendos:

Miratohet rendi i ditës

21 anëtar të Kuvendit prezent në mbledhje

Shqyrtimi i pikës 1.

Në mbledhje munguan 3 anëtar të Kuvendit Agron Avdiaj VV, Besa Ferati LDK deh Lluljeta Zeqira LDK, si dhe tre anëtar të Kuvendit që ende nuk janë zëvendësuar nga KQZ-ja për shkak se ende nuk janë petrifikuar anëtarët dhe ne jemi sot vetëm me 21 anëtar prezentë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi – vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutim në procesverbal, Kuvendi i Komunës vendosi:

Miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar me shumicë të votave 16 për dhe 5 abstenim

21 anëtar të Kuvendit prezent në mbledhje

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi – vazhdojmë me piken e tretë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit për shpalljen qytetar nderit z. Peter Benyer MdB;

Kryetari i Komunës – përshëndet të gjithë të pranishmit dhe bënë prezantimin e biografisë së z. Peter Benyer MdB,

PETER BEYER MdB

Anëtar i Komitetit të Punëve të Jashtme

Anëtar i Komisionit për Çështje të Bashkimit Evropian (zëvendës-kryetar) Anëtar i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës Strasburg

Kordinator për bashkëpunim transatlantik në Qeverin Federale pran zyrës së Jashtme Federale.

Vice President i Shoqërisë së Evropës Juglindore, Mynih

Jeta.

I lindur me 25 dhjetor 1970 në Ratingen Gjermani ,ku edhe kreu Shkollën fillore dhe gjimnazin në vitin 1991, përfundon shërbimin ushtarak si një udhëheqës kompanije në Euppertal.

Menjëherë pas mbarimit të shërbimit ushtarak fillon studimet për drejtësi dhe shkencat politike në Universitetin Heinrich-Heine në Düsseldorf.

Ruga jetësore dhe profesionale e dërgon në Bon, ku përveç studimëve në Jurisprudenc në Universitetin Rheinische Friedrich-Ëilhelms studion edhe në histori dhe fillon jetën politike.

Gjatë studimëve ka qenë edhe pjesë e Universitetin Gjerman në Shkencat Administrative në Speyer.

Pas diplomimit, ka punuar në disa firma ndërkombëtare si përfaqësues ligjore në US Mayer, Broën & Platt (tani Mayer Broën) në Këln, në firmat Brinks, Hofer, Gilson & Lione (Chicago, USA) dhe Murchison dhe Cumming (Los Angeles, USA).

Në vitin 2001, mbaron Master në Universitetin e Virxhinias (Charlottesville, SHBA). Pas kësaj ka punuar si avokat në mbrojtjen e pronësisë intelektuale.

Është anëtar i CDU që nga viti 1996. Që nga viti 2004 ka mbajtur disa poste të ndryshme në nivel lokal. Në zgjedhjet e përgjithshme në shtator të vitit 2009 u zgjedhë për herë të parë si kandidat i CDU me 39.8 për qind të votave drejtpërdrejt në Bundestagun Gjerman.

Fitorja e tij dhe e, CDU-us përsërit edhe në vitin 2013, me 45.6 përqind të votave. Në zgjedhjet për Bundestagun Gjerman të vitit 2017, përsër zgjidhet në Bundestagun.

Në prill të vitit 2018, Qëveria federale i cakton një detyrë shumë delikate duke e emëruar atë si kordinator për bashkëpunim transatlantik dhe si një urë midis Kancelares Merkel dhe Prësitentit të SHBA-se Donald Tramp.

Ka dy fëmijë të moshës shkollore dhe jeton në Ratingen.

Ndërsa kontributi i tij për Kosovën është.

Si anëtar i Bundestagut në tre mandate ka mbështetur dhe mbrojtur praninë e KFOR-it Gjermanë dhe NATO-së në Kosovë.

Është një mik i cili ka lobuar për Kosovën jo vetëm në SHBA dhe në Këshillin e Evropës, por edhe si i emëruar nga Qëveria Gjermanë për kordinimin transatlantik.

Tani është e sigurtë se Kosova tani do jetë temë e politikës transatlantike Pasi një rol vendimtar për Kosovën do të kenë Gjermanët dhe Amerikanët.

Peter Beyer ka mbështetur Kosovën dhe pagën në rajonë.

Ai për të ndihmuar Kosovën në përgatitjen e kuadrateve të reja mori praktikantë nga Kosova.

Ai mbështeti edhe intergrimin e të rinjve në jetën politike në Gjermani dhe duke kntribuar për integrimin e tyre si shembull tipik kemi edhe Rita Hajdarin dhe Besnik Këlmendin dhe shumë të tjer, ku janë të kyqurë drejtëpërdrejt në jetën politik dhe duke punura dhe kontribuar në institucionët publike në Gjermani.

Radoš Repanović – përshëndet të gjithë të pranishmit, ne nuk e kemi pasur të përkthyer ne serbisht biografën.

Kryesuesi – për shkak se ka pasur shumë material nuk ka mundur të përkthehet ndoshta kjo është arsyeja.

Radoš Repanović - çka ka bërë për komunën e Istogut z. Peter Benyer MdB,

Kryetari i Komunës – nuk mund të them se ka kontribuar diçka drejtë perses drejti në komunën e Istogut gjë që nuk do të thotë që nuk do të kontribuoj, ai do ta vizitoj Kosovën dhe Istogun dhe nëse aj shpallet sot qytetar nderit, ne në një seancë të caktuar do ti dorëzojmë këtë vendim dhe unë jam shumë i bindur që do te kontribuoj për komunën tonë. Gjermanët njihen si njerëz të fjalës aj ka shpreh interesim se ka pas shumë komuna që kane shpreh interesim, sidomos Peja që ta shpall qytetar nderit mirëpo aj nuk ka pranuar ka dashur pikërisht ne Istog, ka shpreh edhe një interesim tjetër do te dëshiroja te shpallem ne mënyra unanime, kështu që unë do te kërkoja edhe prej juve Radosh votën se edhe ju jeni qytetare te komunës tone dhe unë mendoj që do te ishte mire, ajo na bënë nderë neve dhe këtu nuk shoh politizime dhe unë këtu nuk kam ndonjë interes personal t jeni te sigurt, është interes i përbashkët unë as që e njoh personalisht, kurrë skam pas takim me të vetëm.

Arif Elshani- Faleminderit kryesues, sikur unë të pyetsha 90 milion Gjerman i kisha bë qytetar te nderit ,kjo na bon nder të gjithë neve. Siç shihet gjermani nuk ka kontribut kurgjë për Istogun dhe si parakusht dihet çka është por unë jam i kënaqur që ne duhet ta votojmë këtë por unë i them kryetarit që në të ardhmen nëse ne shpallim qytetarë

nderi ai duhet te përkushtohet bindshëm sidomos për komunën e Istogut, se me e marr një titull qytetarë nderi prej një komune nuk është pak. Ne kemi dy qytetarë nderi, kemi Çekun ish administratorin që ka kontribut kemi edhe gjeneralin Stivën Shuk që edhe ai flitet që ka kontribut për Istogun e pe votojmë sot një njeri që nuk ka kontribuar ,qenka me një biografi te bujshme por kërkoj nga kryetari që ai te kontribuoj për Komunën e Istogut që ka shumë nevojë.

Arben Kabashi- Një pyetje desha me ja ba kryetarit, a bon pjesë ky delegat ne partine popullore EPP-në?

Haki Rugova- CDU-ja është anëtarë e EPP-së

Arben Kabashi-Ama unë jam pro për ta votuar.

Naim Imeraj –Përsëndet të gjithë të pranishmit, dëshiroj ta shpreh mendimin tim lidhur me këtë iniciativë pavarësisht që qenka e njëanshme unë mendoj që kontributi i pare i zotërisë ne fjale me këtë shkrim kaq voluminoz, kaq përmbajtjesorë si në aspektin profesional ashtu edhe te kontributit ne jetën shoqërore jo vetëm të republikës federale gjermane por edhe politikës së jashtme të saj. Besoj që argumenti i jon sot është që pikërisht ne na ka nderu me përzgjedhjen që te jetë qytetar nderi i komunës sonë, kontributi i pare është që na ka zgjedh neve si komunë që të jetë qytetarë nderi sepse une për veten do ta zgjidhja Prishtinën apo Prizrenin se kisha dit as ku është Istogu. Besoj që ka një konstalacion të argumentimit historik të cilin plotësisht e përqafoj nëse është një prej elementeve që ai e ka pas parasysh. Në emër te grupit parlamentar të aleancës për ardhmërinë e Kosovës Pro para votimit.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka, Hedh në votim propozim Vendimin për shpallje qytetar nderit të z. Peter Beyer Mdb

Miraton me vota unanime.

21 anëtar të Kuvendit prezent në mbledhje

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi – propozon që të vazhdohet me piken e katërt të rendit të ditë Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2019-2021,

Osmon Sadikaj, Zyrtar kryesor Financiar – prezantoi dhe sqaroi Draft Buxhetit për vitin 2019-2021,

Arif Elshani- Ky është viti i 5 që unë si anëtar i këtij kuvendi marr pjesë ne votimin e buxhetit dhe disa vite kam insistuar që edhe unë ta shti ndonjë projekt që komuna e Istogut ta realizoj por tentimet e mija kanë qen te kota dhe asnjëherë nuk me është dhënë ndonjë mundësi që unë si një anëtar i kuvendit me numër të caktuar të votave të shti një projekt. Mendoj që e kom meritua që edhe unë ta shti një projekt se paku, me kanë shti me shenja të kuqe dhe në fund mi kanë hekur, mendoj që unë edhe qytetaret e

unë i përfaqësoj kemi kontribuo që ta kemi një projekt. Unë ju përgjigja ftesës kryetarit për votimin e gjermanit e votova, mendoj që kryetari është dashtë me than tija dhamë Arifit naj projekt edhe qeta njerëz që i ka rreth vetit ata qytetar që të kanë te drejt edhe ata te realizojnë, kom kërkuar disa herë të BajramHaxhit për 4 vjet nuk janë bërë, janë hi asfaltimi i rrugëve pa emër mund të bëhet kamë kërkuar në disa lagje, kamë kërkuar edhe në Saradran ku në këtë vit janë bërë 40 mijë euro. 4 vjetë ky viti i 5 por 40 mijë ju kanë dhen edhe Cerrcesë me vite ju kanë dhënë 3a 400 mijë euro dhe mendoj që ky buxhet nuk është ma për të gjithë qytetaret e Istogut siç e kamë thëna edhe shumë here i cili ndahet por për interesa te një grupi të caktuar te caktuara ndoshta edhe partijake por jo edhe për qytetaret e tjerë. Unë kam shume të flas por nuk dua të flas ma shume, i kemi dy projekte që mendoj që janë të dëmshme për komunën e Istogut.

1.regjistrimi i pronave komunale që është 50 mijë euro po fatkeqësisht kemi njoftim dhenjë për kontratë që këtë projekt duhet me e marr Nois kompani me disa firma një kompani që është me e shtrenjtë një kompani që shumë here kjo është hera e tret që merr shumë vlara një here 200 e sa mijë vitin e kaluar në korrik ka marr 87 mijë shenjtërimi në pyje tash i merr 72 mijë, mendoj se në Istog ka gjeodet mjaftë po ka pasur edhe komuna njerëz që kjo punë është shumë e ndjeshme ndoshta është dashur që me punëtoret e komunës të kryhet kjo punë dhe të shpërblehet se ky është viti i 5 që kjo kompani shpërblehet dukshëm me një interes shumë të madh, vitin e kaluar ka marrë projektimet se çeto projekte Peja i kryen me punëtoret e komunës ndërsa ne i kemi dhenë 218 mijë ato punë që i ka dhënë 87 mijë vjetë që i ka marr kjo kompani Peja i ish krye vetë, edhe sot Peja projektimin e rrugëve trotuareve i bene vetë po e marr shembull Pejën po kështu janë shumë komuna. Prapë dojmë me shpall një tender të njëjte, e kemi shpall kemi vendim prej OSHP-së, kemi një urdhër që mendoj, që Kryetari duhet me e ditë që nuk bënë me ju dhënë asaj të njëjtës kompani që ju ka dhënë viteve të kaluara. Kryesues të lutem mos me ndërprit së unë jam në temë dhe propozimet që janë në këtë projekt buxhet janë për interesa personale, nëse dikush mundet me ma demantu se nuk është ashtu ja ku është urdhëresa nga OSHP-ja, që po donë me ja dhënë të njëjtës që jua keni dhënë në të kaluarën. E kemi një urdhëresë që thotë mos me ja dhen me asaj firme që ja ke dhanë para dy viteve 60 mijë euro po prape dojmë me jua dhënë ka ardhur vendimi nga OSHP-ja tani ka ardhur urdhëresa, more kryetar mos me kanë njerëzit e fort kjo urdhëresë kogja e fshtire është, unë po mendoj që komuna e Istogut isha dashur Kryetari vet personalisht me i hekur këta njerëz që kanë fituar bollë kemi edhe tjerë njerëz ne që merren me këto punë me projekte të Istogut janë po duhet faktikish vetëm këta me i marr këto për këtë arsye unë mendoj që ky buxhet për mua personalisht është i papranueshëm.

Arben Kabashi, PDK - ky draft është dashur me ndryshe te hartohet dhe te jetë me unik për të gjithë rreth planifikimin për vitin e ardhshëm, nga ajo që pash lehtë mund të konstatohet së ndarja buxhetore për vitin 2019, ju e shihni se nuk ka destinim në zhvillimin ekonomik të Komunës kryesisht mjetet janë ndarë për infrastrukturë të vdekur të cilat nuk ndikojnë në të mirë në punësim as me rritje të standardit të jetesës së qytetarëve të Istogut. Po e marr një shembull te thjeshtë po themi gjithë zhvillimi ekonomik, zhvillimi ekonomik ta marrim zonën industriale Syenë së është zonë e shpallur që shumë vite nuk janë të planifikuara as një cent në atë zonë. Të arsimi nuk ka rritje në këtë fushë e shihni se nuk ka rritje te cilësisë. Të bujqësia në planifikim buxhetorë janë hequr ne dy raste një 40 mijë dhe një 40 mijë drejtoratit po besoj me qëllime të caktuara për dy kanale betonimi i tyre dhe një në pastrim të kanaleve nuk ka

diçka që këta blegtor bujqit që merren me arkitektura të ndryshme nuk është planifikuar diçka rreth këtyre mjeteve për vitin e ardhshëm.

Pyete drejtorin e shërbimeve publike pasi që është drejtoret me vlerë që dy mbledhje na ka shty një draft plan te veprimi që e ka bërë për stacionin e Autobusëve si te nxjerrët prej krizës ku drejtori vet nuk ka planifikuar as një cent për nxjerrjen prej krizës stacionit të Autobusëve që është edhe më borxhe të mëdha, e cila është e themeluar dhe vet nga anëtarët e Kuvendit që kemi marr vendim edhe nuk ka paraparë as një centë. Te drejtor ati tjetër Kulture Rini dhe Sport buxheti që është planifikuar aty nuk është e ndarë as një centë sidomos për klubet sportive të cilat kanë arritur sukses ju e dini që klubet janë ato që e dhënë imazhin më të mirë ose sportin për rinia nuk është e orientuar as një cent nga ana rinore ose klubet sportive ne komunën e Istogut. Si anëtar i Asamblesë që vij nga PDK-ja nisem nga fakti që jam në koalicion edhe me LDK-në, në krijim të këtij draft buxheti ne nuk jemi ftuar, po nisem nga fakti që kurë është votuar KABK nga të gjitha propozimet që kam marr nga nëndegët e PDK- së duke përfshi edhe qytetar tjerë prej te gjitha propozimeve që i kam marrë nga fshatrat janë gjëra elementare që është dashur të përfundoj para 4 a 5 viteve a qojnë ka zhvillimi nuk e di po qojnë nga mirëqenia sociale me shumë që të jua lehtësojnë kushtet ato propozime që kanë qenë po kryesisht këtu sillen po përqindja është 37% e atyre propozimeve që janë hy në këtë drafte buxhet që janë ardhur ka nëndegët e PDK- së në komunën e Istogut ose përmes meje se i kam shpalosur këtu. Çfarë arsye kam si anëtar i kuvendit ku shumica e propozimeve me nevoja që kanë të mi vadës p. Sh Kovraga, Studenica, Uqa, Kërrnina, Zhakovë, në përqindje investimi në ato fshatra është 20 deri më 25% në krahasim më totalin e buxhetit ndërsa sa i përket planifikimeve të mjeteve se ku kanë me u investua ku kanë me u shpenzua mendoj që është destinimi më i madh në këtë draft buxhet pasi që në shumë pozicione nëse e keni parë nuk ka përshkrim te saktë mbi destinimin e mjeteve ku vërehet më së shumti të planifikimi i drejtoratit zhvillimit ekonomik i kini qendrat urbane të ndara me mjete po e zëmë jo po kështu është në draft 140 mijë euro për projektin ndërtimi i rrugëve në qendrën urbane te Istogut 60 mijë të ndara veç për Gurrakoc për infrastrukturë Rrugore nuk është e cekur se cilat rrugë do te ndërtohen 60 mijë euro më 9 rrugë kjo është anomali nuk e kap lapsi hiq mund të shtrohet një rrugë po nuk mund të shtrohen më shumë ose me mirë kish qene me cekë fillon rruga që janë edhe në korniza afatmesme propozimet që i kemi bërë ndoshta nuk jam krejt lokalist aty së janë mbetur shumë mangët për vitin e ardhshëm janë 60 mijë për Gurrakoc asgjë nuk ki as një projekt tjetër e ki në shkollë mirëmbajtja një 10 mi asgjë nuk ki 140 mijë për Istogun atëherë shiko në Istog cilat rrugë janë pa u shtruar është një e cila është në projekt për sivjet që në këtë raste është dashur më ja nisur më herët më e përfundua në këtë vite nuk e di ju vazhdonë veç planifikimi është shumë i dobëte me pas një qeverisje të mirë besoj që pajtohen të gjithë është dashur me i gjet ekspertet me e bërë një planifikim të mirë me krijua hapësire edhe për punë.

Naim Imeraj, AAK - do të jem në kuadër të kornizave kohore zyrtari kryesor financiar i sqaroj disa dilema të cilat ishin në material i sqaroj pikërisht çështja e kalimit të një pjese të mjeteve nga kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale në kategorinë mallra dhe shërbime nëse nuk i jepte këto sqarime ky draft lente me kuptua së është shumë pak zhvillimor e shumë shpenzuese, po vazhdoj të mendoj se ky buxhet në këto korniza që i ka është në harmoni me qarkoren buxhetore nr. 2 prape së prape është jo shumë zhvillimorë jam përpikur që ta bëjë një analizë si ka evoluo kjo masë e planifikuar

financiare për të shpenzuar në vitin 2019 krahasuar më vitin 2018 edhe nëse e konsiderojmë si tersi këtë buxhete del që është një rritje e përgjithshme prej 4,7% që realisht njësia relative ndërsa në njësi absolute rreth 480 mijë euro një rritje e cila ato dilemat e problematikes që i kemi pasur në vitin 2017 e që po vazhdojnë në vitin 2018 mbetën tek unë personalisht si dilema a ka ndikim të planifikimet buxhetore dhe këtë kisha dashur ta marr si përgjegjës suficitet që na janë paraqitur pikërisht në vitin 2017 për shkak të mos realizimit të ridestinimit të mjeteve buxhetore për sa kam njohuri e njëjta është duke ndodhur edhe këtë vite nuk ka rishikim nëse nuk ka ndodhur diçka tjetër edhe po frigona që prape do të kemi implikime për faktin që konceptimi i këtij projekt buxheti deri sot e nga sot e tutje këtë buxhet po shpresoj më vërejtjet që u dhanë paraprakisht prej kolegut Arben nuk ka shkoqitje aq të mirë të projekteve posaçërisht në pjesën e shpenzimeve kapitale në pjesën e mallrave dhe shërbimeve nuk ka shkoqitje ato janë shuma të cilat ndërkohe përgjatë periudhës së shpenzimeve na raportohen në cilat kode janë shpenzuar po prape së prape mendoj ti rikthena një vlerësimi të një skenari me optimist, po dua të jem me optimist e me thanë nëse hiqen pagat dhe mëditjet ky buxhet është 10 % me i lartë se sa buxheti i vitit 2018. Vlen për të dëshiruar çështja e listës të shpenzimet kapitale posaçërisht kur është e lidhur me problematiken e cila është pjesë e buxhetit e planifikimi dhe vjeljes përkatësisht inkasomi të te hyrave vetanake në material e kemi marrë planifikimin e vitit 2018 duke vazhduar realisht 2019, 2020 dhe 2021.

Nga viti 2019 të programet ekonomike të hyrat vetanake si element domethanë, del se nuk është shfaqur ndonjë përkushtim i veçantë me planifikim shumica e nën programeve ekonomike në kuadër të programeve siç janë Administrata, Urbanizmi e tutje janë kopjim i vitit 2018 hiq dy përkatësisht tri programeve të cilat janë bërë ndryshimi për tu arritur shifra e planifikuar e ngritjes së planifikuar e të hyrave që nëse merret me përqindje është 9,41% për fondin 21 është një rritje, të hyrat vetanake me të mëdha për vitin 2019 ndërsa në total 8,2% dua të dha vërejtje i kemi shtyllat mbi te cilat ndërtohet të te hyrat vetanake nder to lejet e ndërtimit në planifikim është zvogëluar sasia e mjeteve që do të inkasohen në leje ndërtimit në leje mjedisore, me ligjin nuk e di këto dy a lejet mjedisore hiqen prej lejes a është pjesë apo hiqet nga taksa, lejet mjedisore janë taksa shtesë në raport me lejet e ndërtimit por prapë së prapë në raport me vitin 2018 është bërë një zvogëlim i lejeve të ndërtimit të planifikimit për inkasomi të lejes së ndërtimit si planifikim në llogari te asaj si planifikim te lejes mjedisore me anë te tatimit në pronë ka. ngel i njëjti e dimë që së paku në raportin vjetorë e dimë që shumat që i planifikojmë në vjelje nuk janë shuma realisht janë shuma që ne planifikojmë që do të mund të mrrimi ti inkasojmë në këtë kuptim nuk ka rritje pavarësisht që unë besoj që sipërfaqet e ndërtimit janë në rritje kështu që edhe obligimet janë në rritje faturime dhe nga ana tjetër ekziston nje program i ri i cili është tatimi në tokë e që mbledhja e borxheve të futura si një në një program tatimi në tok do të jetë për here të parë dhe të shohim si do të shkoj kjo me shumë është çështje se si do të implementimet ndërsa mbledhja e borxheve do te mbetet problem i vjetër. Në këtë mbledhje të borxheve nuk është përfshi shuma e cila deklarohet në raportin e kaluar. Të hyrat vetanake janë një sfida në vitin 2017 kemi pasur një problem për vjeljen e të hyrave dhe po besojmë që do të shkoj me sukses në këto vitet e ardhshme.

Radoš Repanović, SL – nuk do ta votojmë këtë Draft Buxhet është i dobët vetëm katër projekte janë për serbet kjo është shumë qesharake ne jemi tri veta të komitetit joshumicë në të gjithë komunën e Istogut as një projekt për komitetit joshumicë.

Zenel Shatri, LDK – përshëndet të gjithë të pranishmit, të buxheti për vitin 2019 është një projekt ku nuk është në nivelin me të dëshiruar dhe me të mirë që është e mundur por mundësia buxhetore është e kjo jemi munduar që në mënyrën me të mirë të mundshme të jetë i hartuar ky projekt i hartuar nga ekzekutivi i komunës ka ardhur në KPF aty ne e kemi plotësuar me disa vërejtje dhe ato projekte që i kemi propozuar % aprovuar dhe tani janë në këtë draft këtu kurse në diskutimin PUBLIK po ashtu kemi marr disa propozime nga qytetaret dhe i kemi shqyrtu prioritetet e këtyre projekteve dhe i kemi shtri disa projekte neper shkolla furnizimin e bibliotekave te shkollave dhe të disa rrugëve por sipas mundësive buxhetore është i hartuar projekti në mënyrën me të mirë të mundshme në bazë të buxhetit që e kemi.

Naim Behlulaj, LDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, i falënderon për qeverisjen e mirë dhe kontributin e dhënë nëpër fshatrat e komunës. Jo vetëm në Uçë po në të gjithë territorin e komunës së Istogut, ne si asamblist i përfaqësojmë interesat e qytetarit pa dallim partie mirëpo po investohet në fshatrat e mivadës. Pyete drejtorin e Bujqësisë kanalin e betonimit të ujitjes në fshatrat Uçë e Rakosh "kanali i Aligjynit" nuk po e shohë në këtë draft ku është problemi? Është i nevojshëm ky kanal drejtori me ka dhen fjalën dhe nuk e ka shti në buxhet hiq. Rruga në lagjen "Muzliaj" është shumë keq në buxhet nuk është besoj që do të përfundoj ajo rrugë.

Ajshe Metaj, PDK - disa gjëra i kemi kaluar në KPF mirëpo të përkrahja e Rinisë pasi që rinia është pjesa e rëndësishme e shoqërisë dhe rreth saj kisha dashur të them se pak është investuar në këtë fushë apo në këtë segment për vet faktin që pjesa e rinis ka nevojë për shumë çka duke i ditur fazat e zhvillimit të tyre sidomos për trajnime të ndryshme dhe për vadisim me intereson edukimi shëndetësor dhe parandalimi i dukurive negative meqë i takoj fushës së arsimit dhe rinia rrjedh përmes këtyre kisha dashur që me tepër me investua rreth edukimit shëndetësor dhe parandalimit të dukurive negative në aspektin e organizimit të trajnimeve të ndryshme për sensibilizim të rinis dmthanë për shkak të shumë sëmundjeve siç është hiv dhe aeds e shoh të arsyeshme që në këtë fushë me kontribut ma shumë sepse rinia është ajo që e mbanë të gjithë kapacitetin e shtetit dhe të gjitha gjërave të tjera.

Mirushe Sadikaj, PDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, Lidhur me rekomandimet e KPF-së a janë të përfshira në draft buxhet këto së shihet se bukur një sasi e mjeteve buxhetore nga bujqësia janë bartir në këto projekte ndoshta bujqësia për vitin në vim nuk është prioritet, të projektet kapitale po shihen në formë të përgjithësuar pa u cekur me emra, mirë po ne kemi mundësi ti shohim shpenzimet gjate seancave të ardhshme e atëhet ndoshta nuk është ndonjë e metë sepse kemi mundësi me i pa të gjitha shpenzimet që bëhen për kode ekonomike edhe pse këto përsëriten e destinacioni përkatës sepse paraqiten projekte tjera ku është qëllimi nuk e dimë. Një projekt kapital që është planifikuar për vitin 2020 trotuari Vrellë - Studenic kërkoj që ky projekt të përfshihet dhe të realizohet në vitin 2019 për shkak të rëndësisë që e ka ky projekt ka qenë krekës e kamotshme e qytetarëve ka qenë premtim i juaji edhe i joni dhe bashk me trotuarin të bëhet edhe ndriçimi Vrellë - Studenic deri të shkolla në Studenicë nuk kërkoj të largohen projekte tjera sepse të gjitha projektet kanë rendësin e tyre secili qytetar e ka interesin aty ky te hy në prioritate.

Rrugët të cilat janë të parapara në fshatin Studenic për vitin 2019 të bëhet një ndërrim të ndërtohet trotuari në vitin 2019 ndërsa rrugët në vitin 2020 vetëm të nderohen projektet.

Kryetari i Komunës - kërkon që të gjitha propozimet të evidentohen. Për çdo vit miratimi i buxhetit debatohet dhe është shumë mirë kemi mendime nga të gjithë dikujt nuk i doket zhvillimore dikujt pak zhvillimor disi si statik gjë që është e vërtet pajtohem plotësisht edhe ne ende nuk po mund të largohemi nga ato shabllone ti quaj tash tradicionale edhe arsyeja është e vetme shumë e qartë këtu kemi shumë interesa nga te gjithë edhe nga komitetet në tersi po edhe subjekteve politike që është krejt normalë mirëpo kemi të bëjmë me mbi 2 milionë euro për investime kapitale, po e shihni se as një projekt nuk e ka shumen mbi 100 mijë euro. Por nga demantet me qytetar si në zyre si të teren kërkesat e qytetarëve 80% dominojnë rreth shtrimit të rrugëve asfaltit që kjo nuk është e mirë, a është zhvillimor a jo kjo është pikëpyetje por të mirëqenia e qytetarëve shkon drejt për së drejti pastaj janë shumë e shumë projekte të tilla që janë Rinia edhe gjatë debateve keni parë që për kryetar të Komunave katër a pesë projekte kanë qenë premtime nga të gjithë kandidatët pa përjashtim krejt është folur për sheshin e Istogut, për parkun, shtëpinë e kulturës, ujin e disa projekte tjera që aty jemi përputhu vetëm në këto projekte mirë po ne këto duhet me i realizuar. Nuk mund ta quaj veten si autorë të këtij projekti ne si ekzekutiv e kemi dorëzuar draft Buxhetin Kuvendit me kohë që ta përpunoni KPF-ja e ka përpunuar, ku ky komitet dëshiroj të jetë sa ma dinamik aty përfaqësohen të gjithë. Ashtu siç ju jeni të pa kënaqur me këtë buxhet ashtu jam i pa kënaqur edhe vetë kjo është e natyrshme është normale. Përpilues të këtij buxheti jemi te gjithë bashkë besoni që nuk ka absolutisht as një anim politik ndajë individëve të caktuar në këtë draft Buxhet dhe kjo nuk ka qene as një here. Kemi dërguar propozime për projekte të reja në Ministri. Po mundohem që projektet e mëdha nga ti tërheqim nga donacione sepse komuna nuk ka buxhet të mjaftueshëm për projekte të mëdha, dhe nga shpërblimet që po i marrim. Parku i qytetit pronë e isha radusha tani është kthyer në pronësi të komunës dhe aty do ta ndërtohet parku. Sa i përket mos emërtimit të projekteve Istogu, Banja, Gurrakoci ato duhet ti jepen emrat. Këtu nuk ka as një sekret, këto vende le ti përzgjedhin vet ku me i dërgua ato mjete në cilët projekte. Projektet do ti kenë emrat. Propozimi i Mirushes është shumë me vend le të trotuari është i nevojshëm. Vërejtja e Radoshit ne buxherin nuk e ndajmë me komunitete, dhe nuk mendoj që komunitetet të ndahen jemi të përzier dhe te gjitha projektet prekin edhe komunitetet pakica dhe shumica.

Ardita Idrizaj, AAK - përshëndet te gjithë, në mbledhjen e KPF-së propozova për rregullimin e rrugës në lagjen "Idrizaj" në fshatin Lubozhdë për vitin 2019 por kërkoj që edhe kjo shumë të rritet e pashë që nuk është e mjaftueshme kjo shumë që është nda.

Haki Podrimaj, LDK - ti hedhim ne votim këto propozime.

Kryesuesi- hedh në votim propozimin e Mirushe Sadikaj Rrugët të cilat janë të parapara në fshatin Studenic për vitin 2019 të bëhet një ndërrim të ndërtohet trotuari në vitin 2019 ndërsa rrugët në vitin 2020 vetëm të ndërrohen projektet

19 për

1 kundër

1 abstenim

Miratohet me shumicë votash.

Naim Imeraj, AAK - ne na ka. Ardhur një listë me propozime nga dëgjimi me qytetar dhe kjo listë a është e përfshirë në këtë buxhete? Pas dëgjimit publik ka pasur një mbledhje me anëtarët e KPF- së dhe nëse këto nuk janë të përfshira në buxhet është dashur që të miratohen një here.

Osmon Sadikaj - projektet të cilat janë në këtë listë 80% kanë qenë të përfshira në buxhet ndërsa pjesa tjetër që nuk janë të evidentuara do të evidentohen në kolonën e cila është nga burimet tjera, të gjitha projektet që janë propozuar ngado do të hynë në listë.

Kryesuesi - sqaron.

Naim Imeraj, AAK - disa nga projekte nga dëgjimi publik kanë ndryshuar një prej këtyre që e kam interesin publikisht e shfaqta rruga në lagjen "Idrizaj" ne draftin që ka qenë në dëgjim. Me qytetar i ka pasur 20 mijë euro te planifikuara nga burime tjera tani këtu evidentohen nga burime të hyrat vetanake, ndërsa në rekomandimin e KPF- së thotë i shtohen 20 mijë euro për mu është e kuptueshme që ajo rrugë i ka 40 mijë euro po dua me ditë ku merën

Osmon Sadikaj - projekti është në listë.

Kryesuesi - hedh në votim rekomandimet e KPF-së

16 për

3 kundër

1 abstenim

20 anëtar prezentë.

Miratohen me shumicë votash.

Kuvendi komunal më 16 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenime vendosi:

Që Draft Buxhetit për vitin 2019-2021,

Miratohet me shumicë votash.

20 anëtar prezent, në sallë prezent nuk ishte, z. Arben Kabashi.

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e pestë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për dhenjen në shfrytëzim të pronës Komunale përmes ankand publik për zhvillim ekonomik,

Nënkryetari i Komunës – prezantoi dhe sqaro Propozim Vendimit për dhenjen në shfrytëzim të pronës Komunale përmes ankand publik për zhvillim ekonomik,

Arben Kabashi, PDK - pyetej prona a është e shfrytëzueshme tani, si me marr një vendim me ndryshuar këtë propozim vendim pasi që nuk është e mirë e fshatit, por pronë e kuvendit komunal a kemi të drejt ne ta votojmë ashtu siç është pa e ndryshua qasjen.

Nënkryetari i Komunës - kjo pronë është duke u shfrytëzuar ka qenë në bazë të rregulloreve ekzistuese që ka qenë në vitin 2002 i është dhënë në shfrytëzim deri në vitin 2013 tani ajo pronë do të shpallet në ankand, ankandi është i hapur për të gjithë.

Naim Imeraj, AAK - kemi pasur edhe raste tjera, po besojmë se në atë hapësirë do të ndodh zhvillimi ekonomik dhe parimisht jemi që kjo procedura të shkoj po kisha pasur kënaqësinë që në të ardhmen më u nda parcelat për zhvillim të mirëfilltët ekonomik.

Kryesuesi hedh në votim Propozim Vendimit për dhenjen në shfrytëzim të pronës Komunale përmes ankand publik për zhvillim ekonomik,

Kuvendi komunal më 17 vota për, 3 abstenime vendosi:
Propozim Vendimit për dhenjen në shfrytëzim të pronës Komunale përmes ankand publik për zhvillim ekonomik

Miraton me shumicë votash.

20 anëtar prezent, në sallë nuk është z. Arif Elshani

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e gjashtë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt- Rregullores për të drejtat, detyrat, përgjegjësinë disiplinore të punonjësve në institucionet Edukativo-Arsimore,

Muhamet Ukaj, AAK - rregullorja është mirë e punuar edhe pse ka vend për kritika me ka ra në sy të shkelja e lehtë faqe 15 par. 4.28 thotë evidentimi i orës së mbajtur edhe në rast të mos mbajtjes së sajë. Personalisht nuk e konsideroj shkelje të lehtë por me vetëdije një mësimdhënës evidenton një orë që nuk e ka mbajtur ose veç 5 minuta dhe ka dal, që zakonisht në shkolla fillore nuk ka raste të tilla mirë po në shkolla të mesme sipas bisedave ka raste tilla. Kjo konsideroj që është shkelje e rënd. Propozojnë që kjo shkelje të bëhet shkelje e rënd.

Arben Kabashi, PDK - propozojnë të shtohet një planifikim kohorë për zbatimin e kësaj rregullorja të raportohet për punën angazhimin dhe masat e ndërmarra për çdo 6 muaj në Kuvendë.

Ajshe Metaj, PDK - në rregullore ka gjëra të mira, por disa ka nevojë zëvendësimi i tyre. Posti i zëvendës drejtorit në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog nuk ka, ky post mungon. As pedagog të shkollës nuk ka, mjek nuk ka, stomatolog nuk ka.

Shtëpiaku i shkollës në gjimnazin "Haxhi Zekaj" aj në mungesë të një pastruesi e kryen edhe atë detyra dhe gjysma e ditës i shkon në pastrim.

Roja e shkollës zakonisht është i nevojshëm të jete natën pasi të përfundoj ndërrimi i dytë përndryshe nuk është i nevojshëm.

Ne piken ku thotë roja e natës ju jep ndiem nxënësve në fatkeqësi të hiqet sepse roja e natës nuk është kur nxënësit janë ditën në mësim. Në shkollë roja i natës nuk mbanë shënime vetëm se raporton gojarisht.

Kuzhinieri mund të jetë vetëm në erdhe sepse në shkolla nuk ka kuzhinjerë, a ka ndonjë shkollë në komunën tonë që ka kuzhinë dhe ofron shërbime me ushqim.

Mësimdhënësi mbështetës kushte është.

Propozoj që aj që nuk e mbajnë orën mësimore me u ndëshkua me heqje të mëditjes mirënjohja për mësimdhënësit kisha dashur që pak a shumë të bëhet depolitizimi i profesorëve.

Mirushe Sadikaj, PDK - të neni 6 pika 8 ku thotë se për shkak të kryerjes së ndonjë veprë penale punonjësi është i detyruar që brenda tri ditësh të lajmëroj drejtorin e institucionit.

Cili person e lajmëron veten ne nuk e dimë a është vepër penal a jo. S'po me duket e drejt fjalja.

Nënkryetari i Komunës - propozon të hiqet krejt kjo pikë.

Mirushe Sadikaj, PDK - neni 13 mjeku kontrolli në shkolla

Të shtohen një pik të kontrollohen secila shkollë nga mjeket së paku një here në vit.

Neni 16 detyrat dhe përgjegjësit e rojës, me duket se flet për rojet jashtë objektit të rrethojat e shkollës pika 12 thotë te kontrollohen hyrjet dhe daljen e automjeteve në shkollë, ne nuk kemi sigurim problem është financimi, dhe ky financim mos të bëhet nga nxënësit por nga komuna. Dhe kërkoj depolitizimin e shkollave.

Naim Belulaj, LDK - neni 9 përgjegjësit e sekretarit, po e shohë që sekretari nuk i vendos notat në librin Amë. Propozoj që sekretari të merret me librin Amë, e jo profesorët, se po dalin plot shkrime në libër me mirë të jetë një person me u merr me atë punë siç edhe është tani e jo të gjithë.

Kërkoj që edhe ora e kujdestaris të mbahet të gjendet metoda dhe të vendoset ne shkolla ora e kujdestarisë.

Ajshe Metaj, PDK - mbështet propozimin e Naimit që të ketë or kujdestarie nëpër shkolla është e nevojshme shumë.

Zenel Shatri, LDK - propozon që se paku një here në vite të i vizitoj mjeku dhe stomatologu shkollat te bëjë kontroll të gjithë nxënësve.

Naim Imeraj, AAK - po dua ta kem të qartë pse preambula pjesa hyrjes i referohet vetëm ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Statutit të Komunës. Materiali është shumë voluminoz a ka bazë tjetër.

Nënkryetari i Komunës - sqaron rregulloren.

Hajrush Shoshi, Drejtor i Arsimit- bënë prezantimin dhe sqarimin e rregullores.

Ajshe Metaj, PDK - sigurimi i shkollave a duhet me i pagua nxënësit a duhet komuna ta mbuloj këtë pagesë

Hajrush Shoshi - sa i përket sigurimit është i rregulluar me udhëzim administrativ aty ku prindërit kërkojnë që sigurimi të bëhet ata edhe e bëjnë pagese. Nuk ka shkelje.

Kuvendi Komunal më 17 vota për, dhe 3 abstenime vendosi:
Projekt- Rregullores për të drejtat, detyrat, përgjegjësinë disiplinore të
punonjësve në institucionet Edukativo-Arsimore,

Miraton me shumicë votash.

20 anëtar prezent, në sallë nuk është z. Arif Elshani

Shqyrtimi i pikës 7

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e shtatë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për transferin dhe rialokimin e mjeteve për vitin 2018,

Nënkryetari i Komunës - prezantoi dhe sqaron Propozim Vendimit për transferin dhe rialokimin e mjeteve për vitin 2018,

Arben Kabashi, PDK - këtu kemi të bëjmë me një mos planifikim të mirë të mjeteve për këtë vite, kanë qenë të planifikuara projektet për këtë vit me shuma tjera tani janë rialoku me shuma tjera. Po shkoni vite pas viti me projekte ashti si po alokoni si po doni vetë kjo është që planifikimi është shumë i dobëte unë e votoj së jam më i qu këto projekte.

Nënkryetari i Komunës - është vetëm një projekt që hiqet dhe bartet në projektet tjera ekzistuese. Ndërsa projektet tjera janë teprica e projekteve nga realizimi i atyre projekteve po ju shtohet që të bëhet realizimi i këtyre projekteve.

Naim Imeraj, AAK - shifrat janë po me të thënë drejtën pavarësisht afinitetit së me marr vesh nga pak në këto sene, nuk është e qartë gjuhësisht se ku kanë tepruar dhe ku po shkojnë në këtë draft jo. Ose te na sqaroni ose te keni kujdes se nuk jemi të gjithë të nivelit si ata në financa me kuptua, jemi të thirrur me miratua duhet më pas të qartë çka po ndodhë, i referona fjalitë së parë, a nga projekti a. Në projektin, ta sqaroj dikush ku kanë teprua dhe ku kanë me shkua.

Nënkryetari i Komunës - sqaron, në shërbimet publike projekti ndërtimi i kanalizimit në Padalishtë lagja Beqiraj vlera 40 mijë euro anulohet si i tillë në tersi dhe këto mjete nga ky projekt rialokohen transferohen në ndërtimi i kanalizimit në lagjen Januzaj shtohen 25 mijë euro vlerës ekzistuese pastaj sanimi i gjendjes nga fatkeqësit natyrore i shtohet shuma prej 22mijë e 500 euro ndersa 12 mijë e 500 i shtohen projektin sanimi i gjendjes nga fatkeqësitë natyrore. Betonimi i kanalit ujit jazi Gogaj i shtohet shuma prej 18 mije euro nga betonimi në Cerrollukë.

Kuvendi Komunal më 17 vota për, dhe 3 abstenime vendosi:

Që me përmirësime dhe vërejtjet e dhëna miratohet me shumicë votash Propozim Vendimit për transferin dhe rialokimin e mjeteve për vitin 2018,

Të pranishëm në sall ishin 20 anëtar të Kuvendit, në sallë nuk është z. Arif Elshani

Shqyrtimi i pikës 8

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e tetë të rendit të ditës, Pyetje nga anëtarët e Kuvendit

Ajshe Metaj, PDK - raporti i shpenzimeve rrjedhës të pagat dhe mëditjet pyet për pagat jubilarë siç duket në disa institucione këto paga janë paguar dhe në një shkollë në Drenas pse të në nuk është?

Te shpenzimet kapitale një shpenzim kapital në shkollën ton ku faktikisht është përzgjedhur kompania për lyerjen e shkollës dhe shkolla nuk është lyere, pse kompania nuk e ka krye punën?

Deri ku ka arritur blerja e lloptopeve për asamblistët brenda këtij viti pse mos me u merr.

Arben Kabashi, PDK - kjo e ka efektin negativ në fund të seancës e pa efektshme, për shkak se këtu nuk ka as media dhe qytetaret nuk kanë mundësi ta ndëgjojnë se a është bërë pyetja e tyre edhe kujt me i bë pyetje edhe kjo pikë të jetë pikë e parë ose të vazhdojmë ashtu siç kemi qenë me herët.

Pyetje burgu në Gurrakoc që është jo funksional është bërë strehimore nga njerëzit a është mundësia me bë një zgjidhje për ata njerëz aty mund të ketë ndonjë epidemi dhe po bëhet dem edhe për shtëpinë e pëlqeve të merren hapat të duhur për aty. Është krekës e të gjithë banorëve të Gurrakocit me ngrit këtë çështje.

Naim Imeraj, AAK - pyete, organizimi aktual në administratën komunale a është në përputhje me. Rregulloren nr. 4/2012 që ka hy në fuqi më 1 janar 2013.

Hajrush Shoshi - pagat jubilarë dhe tri pagat e fundit janë në buxhet për vitin e ardhshëm. Deri në këtë vit nuk i kemi pasur.

Nënkryetari i Komunës - sa i përket lloptopeve është përsëritur tenderi është dashur të bëhet reduktimi i mjeteve se ka dalur oferta me e lartë së planifikimi i mjeteve që kemi që ne e kemi bë.

Arben Kabashi, PDK - propozon që lloptopet të ju blihen vetëm. Anëtareve të ri që janë në këtë mandat ndërsa ata që kanë mos të bëhet shpenzim.

Nënkryetari i Komunës - sa i përket strehimores në Gurrakoc kemi informata jemi duke u marr me atë çështje të bëjmë. Një zgjidhje sa më të shpejt. Naim është e vërtet se me atë rregullore e cila është hartuar në vitin 2012 dhe tani janë shtua dy drejtoritë kjo e drejt i takon kryetarit e cila është e përcaktuar me statut të komunës nuk ka kufizime, do të kemi një rregullore tjetër së shpejti.

Hajrush Shoshi - pastrimi i shkollave po kemi problem ende askush nuk ka marr pjesë në tender jemi duke e bërë një tender për dy vite, shumë shpejtë. Kompania i ka pasur 8 mijë euro dhe ka prurë material neper shkolla.

Ajshe Metaj, PDK - të rrinë drejtorat deri në fund të mbledhjes si ne që po rrimë.

Pasi që nuk pati diskutime të tjera, Kryesuesi shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:30.

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**



**Kryesues,
Gjergj Balaj**

